



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
NJËSIA E PROKURIMI

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. 2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS:

**“BLERJE MATERIALE PASTRIMI DHE DEZINFEKTIMI PËR NJËSITË  
SHPENZUESE TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Sapun-33711900-6, Fshesa-39224100-9, Sfungjerë- 39224320-7, Kova-39224330-0

**Fondi Limit: 3,004,512 (tre milion e katër mijë e pesëqind e dymbëdhjetë) lekë pa t.v.sh, i ndarë si më poshtë:**

Për Fakultetin e Mjekësisë vlera e fondit limit është **991,940 (nëntëqind e nëntëdhjetë e një mijë e nëntëqind e dyzetë) lekë pa t.v.sh.**

Për Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike vlera e fondit limit është **925,417 (nëntëqind e njëzetë e pesë mijë e katërqind e shtatëmbëdhjetë) lekë pa t.v.sh**

Për Fakultetin e Mjekësisë Dentare vlera totale vlera e fondit limit është **254,578 (dyqind e pesëdhjetë e katër mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa t.v.sh**

Për Rektoratin e Universitetit të Mjekësisë vlera e fondit limit është **832,577 ( tetëqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë ) lekë pa t.v.sh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, **Universiteti i Mjekësisë, Tiranë**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formulari i ofertës, sipas Shtojcës 1;*

ç. *Lista e çmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.

### 2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

#### 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas Kritereve të Përgjithshme të Kualifikimit.

#### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43, pika të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:*

Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto tre vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron.

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922, datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,*

## 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më pak se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë, fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që AK kërkon të realizojë, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën prej 20% të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore/polisa sigurimi për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.*

**2.3.2.** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën **ISO 9001:2015 ose ekuivalente**, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Kriteri që OE duhet të disponojë Certificate ISO 9001-2015 ose ekuivalente me të “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë”, është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem të organizuar të menaxhimit të cilësisë së furnizimit me mallra që ofron. Menaxhimi i cilësisë i certifikuar

përfaqëson konfirmim zyrtar të një niveli me performancë të besueshme si dhe provën e angazhimit për përmirësim të vazhdueshëm dhe plotësimin e kërkesave. Zbatimi dhe certifikimi i sistemit të manaxhimit të cilësisë sjell besim tek partnerët e biznesit dhe autoritetet në lidhje me produktet dhe shërbimet furnizuese duke ndihmuar për zvogëlimin e humbjeve dhe përmirësimin e efikasitetit të biznesit në tërësi. ISO 9001 ose ekuivalent, përfaqëson standartin ndërkombëtar unanim i njohur si standarti që i përket kërkesave për një sistem manaxhimi të cilësisë. Ky standart aplikohet për çdo shoqëri pavarësisht madhësisë ose fushës së aktivitetit.

2.3.3 Operatorët ekonomikë në ditën dhe orën e hapjes së ofertave, në ambientet e Rektoratit të UMT-së, duhet të paraqesin mostrat për produktet e poshtëshënuara për të provuar pajtueshmërinë me specifikimet teknike të vendosura në shtojcën 5, si më poshtë vijon:

Nr. artikulli	Emërtimi i mallit	Materiale - Specifikime Teknike	Njësi
15	Letër higjenike ( rulon ) me 3 fije ( shtresa ), cilësore	Leter higjenike ne jo me pak se 10 rula. (3 shtresa, me keputje, 1 top me 135 ndarje). Letra te kete ngjyre te bardhe. Duhet qe produktet e brendit te kene certifikate kualiteti. Permasat e nje topi te jene diametri 10 cm dhe lartesia 9,5 cm.Te jete e pajisur me skede teknike.	pako
16	Letër higjenike e palosur për duar	Leter per fshirje duarsh, 2 shtresa, ngjyre e bardhe (qe vendosen ne aparatet ekzistuese) ,me paketim jo me pak se 270 fije, me permasa 21x 22 cm, te jete cilesore.Produkti duhet te jete i pajisur me skede teknike.	pako
28	Sapun liquid per duart	Sapun likud për duar. Amballazhimi te jete ne bidona nga 3 deri ne 5 litra.Te jete I certifikuar.Te kete kartat e sigurise dhe te perberjes. Te jete antibacterial dhe me efekt zbutes per lekuren. PH 5.5 +- 0.5	liter
39	Solucion larës xhami	Solucion per larje xhamash, me efekt te thelle pastrimi, ne shishe jo me pak se 750 ml. Te jete prodhim me standarte te EU dhe i certifikuar sipas standarteve. Te kete kartat e sigurise dhe te perberjes.	copë
40	Solucion pastrimi sgrasatore	Pastrues i lenget universal per siperfaqe e njolla te veshtira per tu pastruar, perdoret per siperfaqe te ngurta e te buta, paketimi jo me pak se 750 ml, me sprucim. Të veprojë për pak minuta,të pastrojë mirë dhe të ketë aromë të lehtë	cope

41	Solucion Pastrues dysHEMEJE / pllakash	Solucion per larje pllakash dysHEMEJE. Te jete sa me i koncentruar (1-200 me uje ) te lere arome te lehte pas larjes. Te jete prodhim me standarte te EU dhe i certifikuar sipas standarteve. Te kete kartat e sigurise dhe te perberjes. Masat nga 1 deri ne 10 litra. Te jene linja profesionale. Niveli i PH - (8+/-5%).	liter
----	--	---	-------

**Mostrat duhet të paraqiten të ambalazuara në kuti të shoqëruara me listën e mostrave të paraqitura. Në secilën mostër duhet të vendoset etiketë me numrin e artikullit të paraqitur me nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik.**

*Mosparaqitja e mostrave sipas specifikimeve teknike të kërkuara është kusht për skualifikimin e operatorit ekonomik.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është kërkuar bazuar në pikën 6 të Nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, sipas së cilës: *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike, Mostrat trajtohen si informacion konfidencial dhe janë në kontroll të autoritetit kontraktor. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit”.*

Mostrat e paraqitura do të kontrollohen nëse përmbushin specifikimet teknike të kërkuara, për të dhënë garanci operatorit ekonomik për përmbushjen me sukses të procedurës objekt prokurimi, në përputhje me kërkesat e paraqitura nga njësitë shpenzuese.

2.3.4 Për artikujt me nr. 15, nr. 16, nr. 28, nr. 39, nr. 40, nr. 41 operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim Prodhuesi dhe/ose Kontratë Furnizimi/Bashkëpunimi nga një Distributor i Autorizuar. Autorizimi apo Kontrata duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit apo kontraktuesit (Distributor i Autorizuar) si: telefon, fax, e-mail, website. Në rast paraqitje autorizim nga distributor i autorizuar prej prodhuesit, operatori duhet të paraqesi në letër angazhim ose akt marrëveshje midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme midis tyre si dhe çdo dokumentacion shkresor provues që vërteton lidhjen me prodhuesin.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

*miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që janë të autorizuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për tregtimin e pajisjeve dhe kryerjen e shërbimeve dhe riparimeve në rast defekti, brenda periudhës së garancisë. Në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor ka garanci që po hyn në marrëdhënie kontraktuale me një operator ekonomik serioz në treg, që ka autorizim për kryerjen e aktivitetit objekt prokurimi dhe siguron lidhjen përkatëse me subjektin që ka dhënë autorizimin.*

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë se merr përsipër me anë të mjeteve të tij të bëjë furnizimin e mallit objekt prokurimi në adresën e Autoritetit Kontraktor, me shpenzimet e vet operatorit ekonomik.

**Kjo kërkesë shërben si siguri për Autoritetin Kontraktor, për realizimin e transportit me shpenzimet e operatorit ekonomik fitues.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhër nr. 240, datë 31.10.2023 duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke perlllogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve të nenit 4, pika 38/b, nenin 36 të ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik”, nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

## **NJËSIA E PROKURIMIT:**